

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Ministria e Punëve të Punës dhe Transferave
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Inspektorati Qendror i Punës
Centralna Inspektorat Rada
Central Labour Inspectorate

No./Nr./No. 37 Nr. Dat./Dt./Date 01
Data/Datum/Dat. 30 01 2026
RRE/AR / FERIZAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Financave, Punës dhe Transferave - Ministarstvo Finansija, Rada i
Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate



INSPEKTORATI
QENDROR I PUNËS

Inspektori për siguri dhe shëndet në punë [REDAKTUAR] me nr. [REDAKTUAR], bazuar në dispozitën e nenit 2 dhe 5 të Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë dhe Ligjit Nr.03/L-017 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligji për Inspektimet Nr 08/L-067 neni 22 dhe neni 24, neni 94 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 neni 24 të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 6 te ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosove i plotësuar dhe ndryshuar me neni 69 te ligjit nr.08/L-176 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të veqanta Administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitën e nenit 44 ,neni 47 , neni 97 dhe neni 98 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bie këtë:

V E N D I M

Procedura administrative e nisur sipas detyres zyrtare inspektim te planifikuar dhe riinspektim në subjektin Kipper Market SHPK me NUI 811936296, me seli ne Rr. Astrit Bytyqi- Ferizaj ,përfundon me njoftimin e këtij akti administrativ.

A r s y e t i m

Gjatë inspektimit dhe riinspektimit në subjektin e lartëcekur është kryer inspektin nga siguria dhe shëndeti në punë në mbikëqyrjen e zbatimit dispozitave të Ligji për siguri dhe shëndet në punë nr.04/L-161, Ligji për Inspektimet 08/L-067, konform kompetencës së veprimit janë shqyrtuar shkresat- dokumentacioni i nevojshëm gjatë inspektimit dhe riinspektimit si dhe është përpiluar Procesverbal inspektues me Nr.12/2026 date 12.01.2026 dhe Procesverbal ri inspektues Nr. 81/2026 date 27.01.2026, është konstatuar gjendja faktike se punëdhënësi Kipper Market SHPK me NUI 811936296, me seli ne Rr. Astrit Bytyqi- Ferizaj nuk ka konsumuar shkelje të dispozitës se Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, neni 97 paragrafi 1 dhe neni 98 të Ligjit Nr. 05/L-31 të LPPA, pala me këtë akt administrativ njoftohet për përfundimin e procedurës administrative.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky Vendim është përpiluar në katër 2 ekzemplarë identik. Nga një ekzemplar i dorëzohet: palëve në procedurë, ndërsa ekzemplarët tjerë i mbesin Inspektoratit Qendror të Punës -Rajoni Ferizaj për procedurë të mëtutjeshme.

Inspektori i Sigurisë në Punë
[REDAKTUAR]

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të parashtrojë ankesë ne komisionin e ankesave pranë MFPT në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të këtij Vendimi. Ankesa ushtrohet përmes Zyrës së Inspektorëve të Punës në Ferizaj, Rr.Vëllezërit Gërvalla”, Objekti i Administratës Pensionale, zyre nr.2.